REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 43/23
Datë/Datum. 03.02.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I *EKSPERTIT SHQYRTUES*

Eksperti shqyrtues:	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të ekspertizës*	*Nr. i Lëndës*
Emri: Besim *Mbiemri: MULAJ* *Nënshkrimi:*	23.01.2023	02.02.2023	43/23

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.01.2023 Operatori Ekonomik PROGRES L.L.C. Çikatovë e Re Gllogoc, kanë parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me nr.**43/23**, kundër B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 05.01.2023 lidhur dhe Anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Rregullimi i kanalizimit ne rrugën Naim Frashëri", me nr. të prokurimit: 656-22-13971-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Ferizaj.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur lloji i kontratës: Kontratën Publike – Punë, vlera totale e parashikuar e kontratës është : 170,000.00€, me kohëzgjatje prej 36 muaj.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:

Njoftimit për Kontratë.....me datën: 06.12.2022;

Përgatitja e Dosjes së Tenderit: .....me datën: 06.12.2022;

B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara me datën:..... 16.12.2022;

Sqarimet e fundit nga AK.....me datën: 23.09.2022;

Hapje e Ofertave:.....me datën: 27.12.2022;

B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.....me datën: 05.01.2023;

Kërkesa për Rishqyrtim.....me datën: 10.01.2023;

Vendimi mbi pezullimin e aktivitetit të Prokurimit nga AK.....me datën: 10.01.2023;

Vendimi i AK-së në lidhje me kërkesat për Rishqyrtim..... me datën: 12.01.2023;

Ankesat e parashtruar në OSHP.....me datën: 17.01.2023;

Vendimi mbi pezullimin e aktivitetit të Prokurimit për Lot – 1 nga AK.....me datën: 11.01.2023;

Ankesa/t nuk është e përsëritur. JO

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE-së ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Pretendimi i Dispozitat Ligjore të shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas Operatorit Ekonomik PROGRES L.L.C. Çikatovë e Re Gllogoc

Ligji Nr.04/L-042 per prokurimin Publik te Republikes se Kosoves, i ndryshuar dhe i plotesuar me ligjin Nr.04L-237, ligjin Nr.05/L-068, ligjin Nr.05/L-092
Neni 1 i LPP: Qëllimi
Neni 7 i LPP: Barazia në trajtim jo diskriminimi
Neni 10 i LPP: Mjetet për promovimin e Transparencës
Neni 13 i LPP: Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik
Neni 59 i LPP: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 i LPP: Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 69 i LPP: Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Me datë: 07.12.2022 Kuvendi Komunal Ferizaj ka shpallur inicimin e aktivitetit të prokurimit me titull: Rregullimi i kanalizimit në rrugën Naim Frashëri me numër të prokurimit: 656-22-13971-5-2-1 Autoriteti Kontraktues me datë 05.01.2023 ka bërë publikimin e njoftimit mbi vendimin e AK-së tek i cili vendim AK rekomandon për shpërblim me kontratë OE Berisha Company SH.A Menjehere pas vendimit ne kemi bërë Kërkesë për qasje në dokumentacion zyrtarë, ku qasja na është lejuar me datë: 06.01.2023. Pas analizimit të dokumentacionit mund të thuhet se gjatë procedurës formale të vlersimit të ofertave që kanë qenë pjesemarrese në këtë procedur tenderimi nxjerrjes së vendimeve AK nuk ka zbatuar në mënyr të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së për shkak që gjatë vlerësimit komisioni vleresues nuk ka verpuar konform kërkesave të përcaktuara në njoftimin për kontrate dhe dosjes së tenderit dhe ka bere shkelje te deklaratave nen betim sipas ligjit Nr.04/L-042 per prokurimin Publik te Republikes se Kosoves, i ndryshuar dhe i plotesuar me ligjin Nr.04L-237, ligjin Nr.05/L-092 Në vazhdim ofrojmë një deklarat të qartë të detajuar dhe të faktuar me argumente të bazuara për secilën nga pretendimet ankimore kundrejtë vendimit të AK-së. Pretendeimet Ankimore: Pretendimet ankimore janë të ndara në dy pjesë pjesa e

parë përfshin pretendimet ankimore për shkeljet e AK-së gjatë vlerësimit të ofertës tonë ndërsa pjesa tjetër përfshin pretendimet ankimore ndaj ofertës së kompanisë të shpallur fituese.

Pretendimi nr.1

- Ne pas qasjes veqmas dokumentacionit përkatës kemi bërë kërkese dhe na është ofruar edhe raporti i vleresimit të kompanive nga komisioni vlereues, ku ne këtë raport kemi pare që në çdo pikë komisioni vleresues na ka shpallur të papergjegjshem,ku ne posedojme të gjitha dokumentet dhe kemi permbushur të gjitha kerkesat e dosjes se tenderit ashtu siq janë kërkuar dhe shihet qartas që komisioni vleresues fare nuk e ka shiquar oferten tonë të dorëzuar por vetem të OE të shpallur fitues përkunder faktit që ne jemi tenderi i përgjegjshëm me dokumentacion dhe me çmimin me te ulet dhe sipas kriterit te inicuar nga vet AK kriteret për dhenien e kontrates sipas kerkesave,te parashtruara nga ana e AK-se ku dhe shihet qartas që Komisioni vlereues ka shkelur deklaraten nën betim dhe e cila bie në kundershtim me ligjin 1,7,10 dhe të gjitha ligjet e lartecekura. Neve si kompani autoriteti kontraktues në vendimin për njoftimin për kontrate na ka elimuar me arsyetimin se paisjen frezë qe e kemi ofruar nuk përmbush kërkesat e dosjes së tenderit, ne fakt ne kemi ofruar një freze e cila është adekuat sipas kerkeses dhe është sipas specifikave të dosjes se tenderit, dhe eliminimi yne nga kjo procedure per nje pretendendim i cili nuk qendron fare eshte nje shkelje e deklarates nen betim te komisionit vleresues pasi qe vleresimi nuk eshte bere sipas kritereve ne dosjen e tenderit dhe njoftimit per kontrate. Ju keni bere favorizim te kompanise se caktuar pasi qe ne kemi qene nje GOE i pergjegjshem dhe me qmimin me te ulet sipas kritreve te vleresimit, pasi qe edhe ne dosjen e tenderit eshte e cekur qe vleresimi do te behet permes krirerit te vleresimt :tenderi i pergjegjshem me çmimin me te ulet.

Kriteri për Dhënie të kontratës i vendosur nga AK në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit **Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët**

Pretendimi nr.2

1. OE i shpallur fitues Berisha Company Sh.A te kërkesa kapaciteti teknik dhe profesional ka ofruar inxhinieret e gjeodezisë ku njeri nga inigjinieret Florent Emini eshte i diplomuar në Bosnje ndersa inxhinieri tjeter Agim Hajredini e ka te ofruar diplomen ne gjuhen Kroate ku si dëshmi dokumentare inxhinieret ne fjalë nuk kan të ofruar diplomat e perkthyera ne gjuhet zyrtare qe lejohet sipas LPP-se neni 13 Perdorimi i gjuheve zyrtare. Në këtë pikë OE ka bërë shkelje të nenit të lartecekur.
2. Sa i përket kërkesës në dosjen e tenderit një puntor të certifikuar për iso 9001-2015, OE i shpallur fitues Berisha Company Sh.A në kërkesën e lartëcekur ka prezantuar një punetor me certifikat vetëm të bazuar në ISO standarde 9001-2015.
Ne pas qasjes në dokumentacion zyrtarë dhe vendimit të kereksës për rishqyrtim të dates:12.01.2023 ku në përgjigjet e pikave ankimore AK i është shmangur përgjigjes për këtë pikë ankimore të drejtuar nga ana jonë dhe pas kësaj ne kemi kontaktuar me kompanin konsulente N.Sh. Ambienti të cilës i përket certifikata e ofruar nga OE dhe kemi pranuar pergjigje që kjo certifikat eshte certifikat trajnimi pasiqe z.Hysen Berisha ka ndjekur tranimet per sistemin e menaxhimit te cilesise dhe eshte paisur me kete certifikat vetem te bazuar ne standardet ISO.
Kjo certifikat nuk permban numer serik dhe kompania e cila ka lëshuar kete certifikate nuk eshte e akredituar ne kete drejtim, nuk posedon as Web-Faqe ku ne mund te bejme verifikimin e validitetit te certifikates sic jane te hapura ne verifikim trupat certifikuese të tjera, dhe me këtë OE nuk i plotëson kushtet teknike profesionale 9.1 dhe 9.2
Për më shumë detaje rreth pretendimit ankimorë gjeni të bashkangjitur të dokumentuar certifikatën dhe komunikimin me N.Sh Ambienti sa i perket certifikates në fjalë.
3. Në listen e paisjeve sipas kërkeses Frez OE i shpallur fitues ka ofruar marreveshje me Infra plus

SH.P.K e cila marreveshje nuk është e noterizuar sipas kërkesës të parashtruar ne FTD siç kërkohet: "Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët dhe e noterizuar"

Pretendimi nr.3

1. OE tjeter i shpallur i eliminuar Arlindi SHPK ky OE eshte eliminuar nga AK me arsyetimin se mungon sigurimi i tenderit, mirepo në fakt, OE në fjalë nuk ka përmushur asnjë kërkesë të dosjes së tenderit përveqse kërkesën për kontrata të ngjajshme, nga kjo vërehet që vlersimi i ofertës ka qenë siperfaqesisht ku në këtë vleresim vrehet trajtim jo i barabartë i Operatoreve Ekonomik dhe përmban diskriminim të hapur dhe percaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kërkesat mbi mundësin teknik dhe /ose profesional.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Lista e pjesëmarrësve në këtë AP: tri (3) oferta të dorëzuara

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarimi hyrës:

Autoriteti Kontraktues/ Komuna Ferizaj, gjatë këtij aktiviteti të prokurimi me titull "Rregullimi i kanalizimit ne rrugën Naim Frashëri", me nr. të prokurimit: 656-22-13971-5-2-1, ka zbatuar procedurë të hapur lloji i kontratës: Kontratën Publike –Punë, vlera totale e parashikuar e kontratës është: 170,000.00€, me kohëzgjatje prej 36 muaj.

Fillimisht sqaroj së OE ankues ka paraqitur kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues Komuna Ferizaj me pretendimet ankimore si në këtë Ankesë pretendimet kryesore ankimore sipas deklaratës në ankesën e parashtruar nga OE ankues janë kundër B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Kriteri për Dhënie të kontratës i vendosur nga AK në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit **Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët**

Përgjigje në Pretendimi ankimor nr.1

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumentacionit i cili është pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit, dhe pretendimeve ankimore të parashtruara nga Operatori Ekonomik PROGRES L.L.C. Çikatovë e Re Gllogoc, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Rregullimi i kanalizimit ne rrugën Naim Frashëri", me nr. të**

prokurimit: 656-22-13971-5-2-1. së AK gjatë vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka respektuar Kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit (FTD) Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2 **Kapaciteti teknik dhe profesional,** me pretendimi së Operatori Ekonomik PROGRES L.L.C. Çikatovë e Re Gllogoc i ka plotësuar kriteret e vendosura Nga AK në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit, sqaroj me sa vijon:
Operatori ekonomik ankues së bashku me ofertën ka dorëzuar listën e pajisjeve pas analizimi të dokumentacionit të prezantuar (të lista e pajisjeve nr. 9 keni ofruar si përshkrim dy freza hidraulike) njëra e marrë në shfrytëzim me *marrëveshje huazimi* nga Hoxha Kom SH.P.K e cila sipas DUD-it është Frezë për gërryerje të asfaltit, e cila nuk është sipas kritereve të AK-së dhe tjetra e marr me *kontratë huapërdorje* e marrë nga "INFO METAL PLAST – AL" SH.P.K e cila sipas DUD-it Frezë e përdorur pas specifikuar për çka në ketë rast mund te shërbej.
Ndërsa freza për gërryerje të asfaltit është makineri (pajisje) e cila nuk është në harmoni me kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit si e tillë nuk plotëson kriteret e AK-së dhe nuk mund të kryejnë funksionet e njëra tjetrës dhe nuk mund të kërkohen sqarime shtesë sepse dokumentet e paraqitura janë te qarta dhe nuk e ka te arsyeshme AK te kërkoj sqarime.

Mbi këtë konstatoj që ky pretendim ankimorë i OE-së ankues PROGRES L.L.C. është i pa qëndrueshme dhe si tillë refuzohet si i pa bazuara.

Përgjigje në Pretendimi ankimor nr.2

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumentacionit i cili është pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit, dhe pretendimeve ankimore të parashtruara nga Operatori Ekonomik PROGRES L.L.C. Çikatovë e Re Gllogoc, i cili pretendon së AK nuk ka respektuar Kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit FTD Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2 **Kapaciteti teknik dhe profesional,** me pretendimi së OE i rekomanduar fitues nga AK nuk ka plotësuar kriteret sqaroj me sa vijon:

Operatori ekonomik i rekomanduar fitues, së bashku me ofertën ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin sipas kërkesave të AK-së:

Për inxhinierin e gjeodezisë z. Florent Emini së bashku me diplomën është bashkëngjitur edhe vendimi i nostrifikimit të diplomës i lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me datën 30/12/2021 Ref. Nr. 216/246,Licenca si dhe për z. Agim Hajredini është prezantuar diploma në gjuhën serbo kroate e vitit 1994, e vërtetuar dhe protokolluar në atë kohë, gjithashtu për kërkesën për një punëtor me ISO 9001-2015 për të njëjtin është ofruar certifikuar sipas kërkesës së AK-së citat *"Një punëtorë te certifikuar për me ISO 9001 2015"* ku për këtë keni marrë edhe përgjigjen nga kompania që ka lëshuar certifikatën (ne ketë rast nuk ka pas asnjë kërkesë me te detajuar se si duhej te ishte certifikata ISO 9001-2015).

Në listën e makinerisë të ofruar nga OE i shpallur fitues janë të prezantuara tri Freza (nr. rendorë në listë 17,18 dhe 33) prej të cilave në bazë të dokumentacionit të dëshmuara me DUD doganorë dy janë në pronësi të OE-së fitues dhe për një është ofruar marrëveshje me Infra plus SH.P.K e cila marrëveshje nuk është e noterizuar sipas kërkesës të parashtruar: kriteri citat *"frez hidraulike qe vendoset ne eskavator per grryerjen e kanalit 2 cope". "Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët dhe e noterizuar"* e cila nuk ka qen e nevojshme apo nuk ka rendësi në këtë rast sepse OE i shpallur fitues ka plotësuar kriteret e AK-së, të cilat janë vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit duke prezantuar dy copa ne pronësi te OE si dhe janë sipas kërkesës se AK.

Mbi këtë konstatoj që ky pretendim ankimorë i OE-së ankues PROGRES L.L.C. është i pa qëndrueshme dhe si tillë refuzohet si i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi ankimor nr.3

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumentacionit i cili është pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit, dhe pretendimeve ankimore të parashtruara nga Operatori Ekonomik ankues për Operatori Ekonomik Arlindi SHPK konstatoj së i njëjti nuk ka dorëzuar fare Sigurimi e Tenderit i cili ka qen kriter i vendosur nga AK, çështje e cila sqarohet me neni *28.13 të RRPP-së 001/2022 "Sigurimi i tenderit duhet të dorëzohet i skanuar se bashku me oferte, ndërsa forma origjinale e sigurimit të tenderit do të kërkohet të dorëzohet nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Mos dorëzimi i formës origjinale të sigurimit të tenderit shpije në zbatimin e nenit 99.2 të LPP-së", dhe Neni 38 dhe Neni 40.6 të RRPP- së 001/2022.* Pra është kërkesë administrative kalon / nuk kalon dhe kjo është kërkesë e cila nuk mund te sqarohet apo plotësohet përmes sqarimeve andaj edhe AK nuk ka pas nevoje te analizoj me tepër ketë oferte sepse ne fund te fundit rezultati do te ishte i njëjtë, pra do te eliminohej.

Mbi këtë konstatoj që ky pretendim ankimorë i OE-së Ankues është i pa qëndrueshme dhe si i tillë refuzohet si i pa bazuar.

Mbështetur nga elaborimet e lart përmendura Autoritetin Kontraktues – Komuna Ferizaj, komisioni i vlerësimit dhe ZPP, ka vepruar në përgjithësi ne përputhje me LPP-në, Neni 7. Barazia në Trajtim / Jo diskriminim, ka trajtuar në mënyrë të barabar dhe pa diskriminim të gjithë OE ofertuese në harmoni të plotë me Neni 59. Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, Nenin 40 të RRPP-së *001/2022* Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese, provat e bashkëngjitura, pretendimet e dispozitave ligjore të shkelura, kërkesat e vendosura në Njoftim për Kontratë, Dosjes së Tenderit, B54 Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet, Raporti i komisionit të vlerësimit, Vendimet në Kërkesat për Rishqyrtim konsiderojmë së pretendimet ankimore të OE-së ankues janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla refuzohen si të pa bazuara.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që:
- Ankesa e Operatorit Ekonomik PROGRES L.L.C. Çikatovë e Re Gllogoc **të refuzohet si e pa bazuar.**
- Të mbetet në fuqi Formulari B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 05.01.2023.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Komuna Ferizaj .
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE-së ankues – PROGRES L.L.C. Çikatovë e Re Gllogoc